VENDIM
Nr. 225, datë 28.3.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 180, DATË 31.3.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË KOMUNËN E KOZARËS TË QARKUT TË BERATIT", DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 326, DATË 19.3.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PYJEVE DHE KULLOTAVE QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA KOZARË, TË QARKUT TË BERATIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e një pakësimi në listën e inventarit të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, në territorin administrativ të komunës Kozarë. Lista është me 1 (një) fletë dhe mbaron me numër rendor 2.

2. Miratimin e listës shtesë të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, në territorin administrativ të komunës Kozarë. Lista është me 1 (një) fletë dhe mbaron me numër rendor 10.

3. Miratimin e një pakësimi në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të komunës Kozarë. Lista është me 1 (një) fletë dhe mbaron me numër rendor 1.

4. Miratimin e listës shtesë përfundimtare të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të komunës Kozarë. Lista është me 2 (dy) fletë dhe mbaron me numër rendor 49.

5. Ndryshimet në listën e inventarit dhe në listën përfundimtare të pyjeve dhe kullotave, që transferohen në pronësi, si dhe lidhja 1 (një) i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

6. Ngarkohet Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kozarë, e qarkut të Beratit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha